EKSPOZITA E ARKIVIT TË EMIGRACIONIT SHQIPTAR NË GREQI:

Projekt sfidues për një histori të lënë në heshtje

ERVIN SHEHU[1]

Abstrakt

Artikulli trajton ekspozitën *A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration* (*Një borsë plot me telekarta: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar)*, të organizuar në galerinë "TAVROS" në Athinë (Greqi) midis 18-28 shtator 2024, si një projekt politik dhe kuratorial që ndërthur kujtesën kolektive me aktivizmin shoqëror. Përmes një qasjeje dekoloniale dhe pjesëmarrëse, ekspozita vë në dukje përvojat e emigrantëve shqiptarë si një "kundër-arkiv" që sfidon narrativat

[1] Ervin Shehu është aktivist për të drejtat e emigrantëve dhe doktorant në degën e Antropologjisë Sociale dhe Historisë pranë Universitetit të Egjeut (University of the Aegean) në Athinë, Greqi.

dominuese mbi emigracionin, duke i dhënë përparësi proceseve të formimit të identitetit individual e kolektiv, të ndërtuar në kushtet e lëvizjes, kujtesës dhe ndërveprimit me shoqërinë "vendëse". Duke përdorur objekte personale, materiale pamore dhe dëshmi orale, ekspozita shndërrohet në një hapësirë heterotopike ku e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja ndërthuren në mënyrë refleksive. Artikulli argumenton se, përmes konceptimit të kujtesës si proces dinamik, ekspozita u jep zë subjekteve të skajuara dhe i rikthen emigrantit rolin e dëshmitarit aktiv, duke e pozicionuar arkivimin si akt politik dhe emancipues. Në këtë mënyrë, ndërveprimi me publikun krijon hapësirë për dialog, ndjeshmëri dhe reflektim mbi proceset e emigracionit, duke pohuar rolin e kujtesës si instrument kritik e transformues në rishikimin e marrëdhënieve ndërmjet historisë dhe identitetit në hapësirat e artit bashkëkohor.

Fjalë kyçe: *Arkivi i Emigracionit Shqiptar, kujtesa kolektive, estetika dekoloniale, praktikë kuratoriale, politikë parafytyruese*

- **Galeria e artit "TAVROS"**

Një ish-fabrikë artizanale në lagjen Tavros në Athinë, vitet e fundit është shndërruar në një galeri arti. Kjo ndërtesë nuk mbizotëron në zonë si ndonjë objekt me tipare të veçanta, por është pikërisht të qenit e ngjashme me objektet përreth që e bëjnë të lidhet drejtpërdrejt me hapësirën publike dhe komunitetin lokal. Nga dritaret e katit të parë të kësaj ndërtese pesëkatëshe, pamja panoramike të jep përshtypjen e shkrirjes me rrugët, me ndërtesat identike të rreshtuara përballë saj, me një park të

gjelbëruar, një kompleks pallatesh punëtorësh, faktorë këta që të bëjnë të familjarizohesh menjëherë me hapësirën brenda dhe mjedisin jashtë.

Galeria zë një hapësirë prej 320 metrash katrorë. Pas ndërhyrjeve dhe restaurimeve minimale, u shndërrua në një mjedis funksional arti. Në të nuk ka mure ndarëse apo dhoma të veçanta, veçse disa kolona betoni në distancë të njëjtë nga njëra-tjetra. Me dysheme të shtruar me mozaik tradicional dhe me dritare të gjera në fasadë, nuk të lë përshtypjen e një galerie, domethënë të një hapësire konvencionale arti, ashtu siç jemi të prirur ta përfytyrojmë.

Në katin përdhes të ndërtesës funksionon një palestër boksi. Shpesh, sportistët, në rast hapjeje të ndonjë ekspozite, e vizitojnë atë dhe mandej i rikthehen stërvitjes. Ky është një tregues i thjeshtë që na bën të mendojmë se kjo hapësirë arti përbën një kanal komunikimi me shoqërinë dhe funksionon si laborator për krijimin e ideve artistike, të brumosjes së botëkuptimeve alternative dhe të ndryshimit të mentaliteteve. Në këtë aspekt, përbën një hapësirë arti e cila fokusohet në thellimin, zhvillimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve shoqërore.

Galeria eksploron koncepte si, demokracia, barazia sociale, ekologjia, të drejtat individuale, politike e sociale, koncepte që synohen të adresohen nëpërmjet dialogut, ndërveprimit (*interaction*), programeve edukative, ekspozitave artistike, shfaqjeve dhe programeve komunitare. Në këtë aspekt, u jepet prioritet marrëdhënieve midis artistëve të gjinive të ndryshme dhe komuniteteve lokale, duke krijuar një hapësirë për zërat e mbetur në heshtje dhe të skajuar, që përfshihen në një lloj aktivizmi artistik.

- **Në galeri**

Galeria "TAVROS" është hapësira në të cilën u mbajt ekspozita e Arkivit të Emigracionit Shqiptar në Greqi. I ftuar të merrja pjesë si bashkëbisedues në një prej ditëve të zhvillimit të saj, u gjenda përballë disa faktorëve mbresëlënës dhe tepër dominues nëpërmjet të cilëve shpalosej karakteri politik dhe social i ekspozitës së arkivit. Ndër to spikasnin: krijimi i një mjedisi mikpritës, i organizuar nga emigrantë shqiptarë, ç'ka vihej re përgjatë orarit të ekspozitës; zhvillimi i diskutimeve në grupe të vogla dhe i bisedave të hapura që i ftonte pjesëmarrësit të thellohen në lidhje me përmbajtjen e objekteve dhe materialeve të paraqitura; përfshirja e emigrantëve shqiptarë në procesin e organizimit të ekspozitës si dhe preokupimi i tyre për të kontribuuar me histori dhe materiale; nxitja e përvojave ndërvepruese nëpërmjet objekteve të prekshme dhe digjitale, si dhe përdorimi i mjeteve të cilat zhvillojnë angazhimin shqisor nëpërmjet ndriçimit, tingujve, zërave, ç'ka e bënin hapësirën më të pasur dhe tërheqëse. Këta faktorë e lidhnin emocionalisht audiencën me hapësirën dhe krijonin intimitet, pasi provokonin kuriozitet, empati (ndjeshmëri) dhe reflektim. Ata konsiderohen si strategji, nëpërmjet të cilave, ekspozitat mund të nxisin lidhje dhe përshtypje të thella si dhe pjesëmarrje aktive.[2]

Gjatë hulumtimit të materialeve, syri më ndeshet me një sërë broshurash e pamfletesh politike të vendosura në tryezën kryesore, që zinte një hapësirë të veçantë të ekspozitës. Shoh arkivin e kolektivit të Forumit të Emigrantëve Shqiptarë, të një

[2] Graham Black, *The Engaging Museum: Developing Museums for Visitor Involvement*, London: Routledge, 2005, f. 62.

organizate politike në të cilën bëja pjesë. Pa e kuptuar emocionohem. Sytë i ngul në një broshurë në të cilën shkruhet: "Strehëza e Emigrantëve Shqiptarë". E ndiej se në këtë hapësirë, ky arkiv ka një rëndësi të veçantë dhe peshë tjetër, pasi në të mishërohet rezistenca ndaj diskriminimit social dhe zyrtar. Krejt papritur, ekspozitën filloj ta imagjinoj si një "strehëz", në të cilën dominojnë zërat e emigrantëve. Ky fakt më ngjalli dëshirën të rikujtoj ato mbresa që lidhen drejtpërdrejt me aktualitetin që, si emigrantë, vazhdojmë të përjetojmë. Me kohë ekspozita filloi të mbushej. Publiku nuk ishte i panjohur për mua. Midis tyre vura re akademikë, studentë, aktivistë, avokatë, emigrantë shqiptarë të moshave të ndryshme, familjarë, gazetarë, etj. – kryesisht një publik i ardhur nga forcat përparimtare e progresive të shoqërisë greke.

- **Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar**

Arkivi i Emigracionit Shqiptar (*Archive of Albanian Migration / AAM*), i nisur në vitin 2022 nga Arkivi i Historisë Sociale Bashkëkohore (*Archeía Sýnchronis Koinonikís Istorías / ASKI*) me mbështetjen e Iniciativës së Fondacionit Stavros Niarhos për Humanitetet Publike (*Stavros Niarchos Foundation Public Humanities Initiative / SNFPHI*), përfaqëson një projekt pilot me buxhet të kufizuar, që synon të hedhë dritë mbi narrativat e anashkaluara në ligjërimin publik në Greqi. AAM nuk është një arkiv etnologjik, megjithatë fokusohet në përvojat e emigracionit shqiptar, duke nxitur një kuptim më të thellë të strukturës shumanëshe të shoqërisë greke.[3]

[3] Shiko: https://snfphi.columbia.edu/events/a-bag-full-of-telephone-cards/ [referuar më 4 korrik 2025].

Arkivi krijohet në një moment kritik për emigracionin shqiptar, nëpërmjet të cilit kujtesa sociale sfidon narrativat dominuese që e kanë përshkruar atë, fillimisht si fenomen kërcënues e mandej si një histori suksesi[4] dhe asimilimi, shpesh këto të krahasuara me rrymat aktuale të emigracionit. Arkivi nxjerr në dukje zërat e emigrantëve, si dhe përvojat e ndryshme e kontradiktore, në të cilin kujtesa sociale interpretohet në shumanshmërinë e saj.[5] Në këtë aspekt, roli i arkivave dhe i arkivistëve është përcaktues në strukturimin e identiteteve, pasi vlerësojnë, koleksionojnë dhe përdorin materiale me të cilat këto identitete ndërtohen.[6] Për emigrantët, ai shërben si hartë,[7] busull

[4] Ilirida Musaraj, "Historicization, Memory, and Antagonistic Narratives: Creating the Archive of Albanian Migration", kumtesë e koordinatores së Arkivit të Emigracionit Shqiptar në simpoziumin *RE:membering the Past: Cultural Memory and Public Humanities*, 17 maj 2024, Aristotle University, Athinë (Greqi): https://www.new.enl.auth.gr/re-membering-the-past/historicization-memory-and-antagonistic-narratives-creating-the-archive-of-albanian-migration/ [referuar më 1 prill 2025].

[5] Një model të tillë të arkivit rreth emigracionit e ndeshim në Qendrën e Dokumentacionit dhe Muzeun e Emigracionit në Gjermani (DOMiD), i cili është një nga shembujt e paktë të angazhimit institucional të bazuar në kërkime mbi emigracionin. Kjo qendër koleksionon materiale që dokumentojnë historinë e emigracionit, një perspektivë që mund të dëshmojë mbi zhvillimin e identitetit transkulturor. Shiko: https://domid.org/en/about-us/projects/ [referuar më 5 korrik 2025].

[6] Elisabeth Kaplan, "We Are What We Collect, We Collect What We Are: Archives and the Construction of Identity", *The American Archivist* vëll. 63, nr. 1, 2000, f. 126–151 (f. 144–145): https://doi.org/10.17723/aarc.63.1.h554377531233l05 [referuar më 12 korrik 2025].

[7] Arjun Appadurai, "Archive and Aspiration", *The Archive Public*, 2012: https://archivepublic.wordpress.com/texts/arjun-appadurai/ [referuar më 1

dhe udhëzues në konsolidimin e identitetit në kushte të pafavorshme dhe kujtesa kolektive, në këtë kontekst, formëson një *kundër-arkiv* përmes qarkullimit të ideve, njohurive dhe strategjive, ç'ka jep mundësinë që këto arkiva të diskutohen jo vetëm në lidhje me konceptin e lëvizjes dhe të braktisjes, por edhe të politikave integruese në vendet e destinacionit, apo ato skajuese.[8]

Projekti ndjek një qasje nga *poshtë-lart*, ku përfshihen studentë shqiptarë të brezit të dytë në organizimim e arkivit si dhe të ekspozitës, të cilët janë aktivistë/mbartës të një identiteti politik. Pavarësisht faktit se në ekspozitë angazhohen emigrantë shqiptarë, nuk mund të ngulmojmë se është një ekspozitë e nxitur dhe që buron nga vetë "komuniteti shqiptar".[9] Sidoqoftë, përfshirja në arkiv dhe në ekspozitë e emigrantëve shqiptarë na shtyn të mendojmë se mund të flitet për një arkiv të *Jetëve Tona*, i cili sfidon modelet tradicionale të arkivimit[10] duke i dhënë zë

---

mars 2025].

[8] Fiona Siegenthaler dhe Cathrine Bublatzky, "(Un)Sighted Archives of Migration—Spaces of Encounter and Resistance: An Introduction", *Visual Anthropology* vëll. 34, nr. 4, 2021, f. 283–295 (f. 292): https://doi.org/10.1080/08949468.2021.1944766 [referuar më 16 prill 2025].

[9] Ervin Shehu, "Komunitetet e migracionit: ndikimi i konceptimeve në protestat sociale", *Teza11*, 29 prill 2023: https://teza11.org/komunitetet-e-migracionit-ndikimi-i-konceptimeve-ne-protestat-sociale/ [referuar më 5 korrik 2025].

[10] Arkivat tradicionale shpesh ndërtohen për t'i shërbyer një historie të unifikuar kombëtare, duke përforcuar identitetet e lidhura me ndërtimin e shtetit ose pastërtisë kulturore. Në kontekstet diasporike, kjo shpesh do të thotë të përpiqesh ta "përshtatësh" diasporën në një histori lineare të atdheut, duke theksuar origjinën kundrejt përvojës.

vetë subjekteve të emigracionit.[11]

Shpesh, fokusimi në arkivat nga poshtë, si një metodë e shtjellimit të kulturave dhe grupeve apo individëve të skajuar, i shtyn arkivistët të kërkojnë përtej mureve zyrtare dhe të angazhohen për dokumentimin e komuniteteve, në bazë të një qasjeje dekoloniale.[12] Prandaj, ata shërbejnë si mjet për të korrigjuar keqinterpretimet historike të arkivave dominuese, përmes një procesi demokratik dhe antihierarkik.[13] Në këtë kuadër, mund ta perceptojmë AAM si një kundër-arkiv të emigracionit, në të cilin ndiqen praktika arkivore që qëndrojnë pjesërisht në kundërshti me praktikat standarde, pasi mbështeten në histori alternative dhe në një imagjinatë politike që evoluojnë nga poshtë.[14]

Në aspektin sociologjik, duket se një arkiv me qasje nga poshtë, mund të ndikojë në zhvillimin e një teorie të përgjithshme të emigracionit, duke iu kundërvënë studimeve që bazohen në të dhëna të nxjerra nga regjistrimet e popullsisë apo nga të tjera zyra

---

[11] Richard N. Juliani, "The Use of Archives in the Study of Immigration and Ethnicity", *The American Archivist* vëll. 39, nr. 4, 1976, f. 469–477 (f. 474): http://www.jstor.org/stable/40291919 [referuar më 9 korrik 2025].

[12] Shiko, për shembull: *Decolonising the Archive*, https://www.decolonisingthearchive.com/about [referuar më 4 korrik 2025].

[13] Anna Robinson-Sweet dhe Michelle Caswell, "Paying It Forward: The Prefigurative Politics of Record Creation", *KULA: Knowledge Creation, Dissemination, and Preservation Studies* vëll. 8, nr. 1, 2025, f. 7: https://doi.org/10.18357/kula.292 [referuar më 18 korrik 2025].

[14] Róisín Ibreck, Peter Rees dhe Martina Tazzioli, "Counter-Archiving Migration: Tracing the Records of Protests against UNHCR", *International Political Sociology* vëll. 18, nr. 4, 2024, olae035, f. 3: https://doi.org/10.1093/ips/olae035 [referuar më 16 prill 2025].

shtetërore, siç janë policia, gjykatat, institucionet korrektuese, postat kufitare, të cilat japin një shkallë të ndryshme saktësie.[15] Ky faktor ndikon në adoptimin e arkivave të ndërhyrjes (*interference*), të cilat shtjellojnë marrëdhëniet midis prodhimit kulturor dhe lëvizjeve sociale.[16]

Marrëdhënia midis arkivave të emigracionit dhe kontekstit historik paraqitet si një proces dialektik: arkivat jo vetëm ndikohen nga rrethanat në të cilat krijohen, por edhe kontribuojnë në formësimin e ideve mbi realitetin e emigracionit[17] duke zbatuar praktika arkivore alternative, siç janë: organizimi i laboratorëve parapërgatitorë me pjesëmarrjen aktive të emigrantëve, komunikimi i rëndësisë së krijimit të arkivit me emigrantë aktivistë, organizimi i ekspozitave me tematika të ndryshme që lidhen drejtpërdrejt me historinë dhe aktualitetin politiko-social të emigracionit.

▪ Ekspozita e Arkivit të Emigracionit Shqiptar

Që të arrijmë të shtjellojmë ekspozitën e arkivit në raport me përmbajtjen dhe praktikat që u ndoqën, është e domosdoshme të

---

[15] J. J. Mangalam dhe Harry K. Schwarzweller, "General Theory in the Study of Migration: Current Needs and Difficulties", *The International Migration Review* vëll. 3, nr. 1, 1968, f. 3–18 (f. 14): https://doi.org/10.2307/3002178 [referuar më 16 korrik 2025].

[16] Alycia Sellie, Jesse Goldstein, Molly Fair dhe Jennifer Hoyer, "Interference Archive: A Free Space for Social Movement Culture", *Archival Science* nr. 15, 2015, f. 453–472: https://doi.org/10.1007/s10502-015-9245-5 [referuar më 20 korrik 2025].

[17] Dominique Daniel, "Documenting the Immigrant and Ethnic Experience in American Archives," *The American Archivist* vëll. 73, nr. 1, 2010, f. 82–104 (f. 82–83): http://www.jstor.org/stable/27802716 [referuar më 1 tetor 2025].

shtrojmë dy problematika. E para: a mund ta konceptojmë ekspozitën si shprehje të estetikës dekoloniale, si një kundër-arkiv i cili kërkon të dekonstruktojë (*deconstruct*) kategoritë narrative dominuese në lidhje me emigracionin shqiptar? Dhe e dyta: cilat ishin praktikat kuratoriale të adoptuara gjatë zhvillimit të ekspozitës me qëllim vënien në dukje të karakterit *parafytyrues* (*prefigurative*[18]) dhe *rezistues* të arkivit?

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, do të ishte më kuptimplotë ta konceptojmë ekspozitën jo thjesht si hapësirë ekspozimi të objekteve por si heterotopi[19] – një hapësirë në të cilën ndërthuren njohuria, kujtesa, identiteti nëpërmjet

[18] Koncepti i referohet arkivave që krijojnë rrjete solidariteti përmes vetë procesit arkivor. Bëhet fjalë për "hapësira të lira parafytyruese" të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me lëvizjet shoqërore. Shiko: Roxanne Lobo, "Archive as Prefigurative Space: Our Lives and Black Feminism in Canada", *Archivaria* nr. 87, 2019, f. 68–86 (f. 79): https://archivaria.ca/index.php/archivaria/article/view/13667 [referuar më 10 korrik 2025].

[19] Koncepti i *heterotopisë* u përpunua nga Michel Foucault, ndryshe i quajtur "hapësira të tjera", të cilat konsiderohen"vende reale...apo kundër-vende, për të reflektuar apo kundërshtuar hapësira të tjera në shoqëri. Janë hapësira që ekzistojnë në realitet dhe mbartin shtresa të ndryshme kuptimi, shpesh duke vendosur përballë tyre realitete kontradiktore. Varrezat, muzetë, bibliotekat, teatrot, kopshtet, panairet, motelet dhe anijet citohen si heterotopi, secila duke ilustruar parime të ndryshme. Foucault argumenton se hapësira, veçanërisht heterotopitë, luajnë rol vendimtar në formësimin e përvojës njerëzore, duke reflektuar strukturat shoqërore dhe duke ofruar hapësira alternative ose të tilla që vijnë në kundërshtim me normat e jetës së përditshme. Shiko: Michel Foucault, "Of Other Spaces: Utopias and Heterotopias", përkth. Jay Miskowiec, *Architecture / Mouvement / Continuité*, tetor 1984: https://web.mit.edu/allanmc/www/foucault1.pdf [referuar më 2 tetor 2025]. Fillimisht paraqitur si "Des Espaces Autres", mars 1967.

praktikave kuratoriale. Këto hapësira formësojnë nocionet dhe përmbajtjet kulturore, mënyrën se si publiku e koncepton historinë, si dhe u japin objekteve kuptime simbolike dhe edukative. Që të flasim për karakterin parafytyrues të ekspozitës, duhet të marrim parasysh se çdo përfshirje apo përjashtim objektesh pasqyron një drejtim ideologjik, duke e bërë ekspozitën dhe arkivin jo neutral, por pjesë aktive të prodhimit të dijes. [20] Përmes dokumenteve, fotografive dhe dëshmive, ekspozita i shndërron historitë personale të emigrantëve në një kujtesë kolektive publike. Si hapësirë heterotopike, ajo shndërrohet në një "vend të vërtetë" (*real space*) në të cilin gjenden në koherencë të plotë, e kaluara (kujtimet e arkivuara), e tashmja (angazhimi publik), dhe e ardhmja alternative (rishqyrtimi dhe rivlerësimi i përkatësisë dhe identitetit). Në këtë drejtim, ekspozita nuk përfaqëson thjesht emigracionin, por e mbruan atë. Si e tillë, ajo bëhet hapësirë imagjinative që pasqyron, kundërshton apo sfidon normat dhe perceptimet dominuese shoqërore.

Ekspozita *A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration* (*Një borsë plot me telekarta: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar*) u mbajt nga 18 deri më 28 shtator 2024, nën kujdesin e kuratoreve Ilirida Musaraj dhe Pati Vardhami. Ajo shërbeu si një moment thelbësor i prezantimit publik të projektit të arkivit, ku paraqitej një ndërthurje e praktikave arkivore dhe kuratoriale, duke e pozicionuar arkivimin si akt politik dhe formë aktivizmi. Nëpërmjet pjesëmarrjes komunitare, ekspozita ofroi një

[20] Michel Foucault, *The Archaeology of Knowledge*, përkth. A. M. Sheridan Smith, Londër dhe Nju Jork: Routledge, 2005, f. 145–146.

platformë për dialog emocional, estetik dhe shoqëror, proces i cili përfshin gjurmimin e marrëdhënieve midis formave, shprehjeve dhe emocioneve, duke i bërë ato po aq të rëndësishme politikisht dhe shoqërisht.[21] Objektet dhe historitë e ekspozuara krijuan një urë lidhëse midis çështjeve publike dhe përvojave individuale, duke theksuar rëndësinë e kujtesës si akt rezistence dhe ndërgjegjësimi.

Pavarësisht mendimit të kuratoreve se ekspozita kishte ngarkesë të "varfër" artistike, në të mund të gjejmë nuanca estetike që shprehen nëpërmjet instalacioneve.[22] Në këtë prizëm, amalgama e dokumentacionit historik dhe shprehjes artistike, transformon hapësirën e ekspozitës në një mjedis "hibrid" dhe alternativ. Si rrjedhojë, ekspozita mund të lexohet edhe përmes konceptit të estetikës relacionale (*relational aesthetics*) ku arti vendoset në shërbim të marrëdhënieve shoqërore, duke krijuar hapësira dialogu, bashkëveprimi dhe bashkëjetese.[23] Këtu, sfera e marrëdhënieve sociale bëhet foleja e aktivitetit artistik, qasje që i jep përparësi bashkëveprimit dhe përvojave relacionale. Në këtë

---

[21] Nina Simon, *The Participatory Museum*, Santa Cruz, CA: Museum 2.0, 2010, f. 45.

[22] Në lidhje me konceptin "instalacion", është e nevojshme të bëhet dallimi midis instalacionit artistik – një prezantim hapësinor, shpesh me një dimension ndërveprues, që synon të ngjallë përjetim emocional – dhe ekspozitës arkivore e cila fokusohet në paraqitjen dhe edukimin përmes materialeve dokumentare. Instalacionet angazhojnë publikun përmes përvojave shqisore dhe pjesëmarrëse, duke shfaqur potencialin e tyre për reflektim kritik e shoqëror. Shiko: Julie H. Reiss, *From Margin to Center: The Spaces of Installation Art*, Cambridge, MA: MIT Press, 1999, f. 93.

[23] Nicolas Bourriaud, *Relational Aesthetics*, përkth. Simon Pleasance dhe Fronza Woods, Dijon: Les Presses du Réel, 2002, f. 45.

mënyrë, praktikat kuratoriale shndërrohen në mjete aktiviste që nxisin fuqizim dhe dukshmëri, duke e përdorur arkivin si hapësirë edukimi dhe veprimi. Materialet e ekspozuara theksojnë aftësinë vetëvepruese të subjektit, duke shmangur narrativën viktimizuese dhe duke i pozicionuar objektet si mjete rezistence. [24] Ekspozita e arkivit i "estetizon" historitë e emigrantëve, duke i kthyer objektet e përditshme, fotografitë dhe dëshmitë personale në artefakte politike. Përdorimi i artit pamor dhe pjesëmarrës mishëron kujtesën sociale të emigrantëve, duke krijuar hapësirë për zërat e vetë subjekteve.[25]

---

[24] Një shembull të tillë na pasqyron *Secondary Archive* (Arkivi Dytësor) i cili, sipas Erëmirë Krasniqit**,** hedh dritë mbi boshllëqet në ligjërimin artistik, duke i dhënë hapësirë zërave të skajuar, grave, gjuhëve dhe rrëfimeve të padukshme. I jep rëndësi shumëllojshmërisë së përvojave dhe historive të ndryshme. Duke eksploruar aspektet kulturore dhe praktikat e paprekshme të lidhura ngushtë me përvojat e grave në art, arkivi ndërton një histori që shpesh nuk ka lënë gjurmë të prekshme. Shiko: Erëmirë Krasniqi dhe Renea Begolli, "Conversation Between the Secondary Archive Kosovo Curators", *Dealing with the Past*, 29 mars 2023: https://dwp-balkan.org/secondary-archive/ [referuar më 8 korrik 2025].

[25] Këtë aspekt e gjejmë edhe tek ekspozita *Heshtjet kumbuese të metalit dhe lëkurës*, kuruar nga Erëmirë Krasniqi, në të cilën ndërthuret kujtesa orale e punëtorëve me instalacionin artistik, duke krijuar një përvojë që rikumbon trupërisht, emocionalisht dhe historikisht. Përdorimi i peizazheve zanore dhe dizajnit ndijor bën që historitë e paprekshme të bëhen të prekshme. Përmes formave simbolike, objektet e përditshme transformohen në metonime të përvojës, duke lidhur dëshminë arkivore me formën pamore. Kjo ekspozitë është pjesë e një qasjeje kuratoriale ku arkivat e traumës, punës dhe skajimit rikthehen si hapësira për takim dhe reflektim kritik. Qasja kuratoriale hedh poshtë neutralitetin që shpesh shoqërohet me arkivat institucionale. Në vend të kësaj, nxirren në dukje fragmentimi, relacionaliteti, veçanërisht në dokumentimin e jetës së grave, duke e vendosur këtë problematikë në një

Në mënyrë që të paraqesim një përmbledhje gjithëpërfshirëse, si për vlerat ashtu edhe për efektshmërinë e ekspozitës, në lidhje me problematikat e shtruara në këtë artikull, është e domosdoshme të përqendrohemi në vlerësimin e materialeve vizuale dhe orale me paraqitjen dhe përdorimin e elementeve multimediale, që konsiderohen si komponentë nëpërmjet të cilëve ekspozita angazhon audiencën e saj dhe nxjerr në dukje rëndësinë dhe rolin e saj si hapësirë *parafytyruese* dhe *rezistuese*.

Një hapësirë të madhe në qendër të galerisë e zinte një tryezë e improvizuar me fibra druri, ngjyrë e bardhë në formë drejtkëndëshi, e vendosur mbi këmbalecë. Mbi të ishin vendosur koleksione nga faqe gazetash, libra, abetare, fjalorë shqip-greqisht, certifikata, diploma, vërtetime e dëshmi të lëshuara nga autoritetet greke, leje qëndrimi, karta jeshile, pasaporta, karta identiteti, fotografi familjare, broshura dhe pamflete, afishe me përmbajtje politike, gazeta në gjuhën shqipe, tableta të lidhura

---

kontekst transnacional dhe jo vetëm brenda kornizave lokale. Shiko: "Koncepti kuratorial i projektit 'Heshtjet kumbuese të metalit dhe lëkurës'", *GazetaExpress.com*, 18 mars 2024: https://www.gazetaexpress.com/koncepti-kuratorial-i-projektit-heshtjet-kumbuese-te-metalit-dhe-lekures/ [referuar më 7 korrik 2025]; "Erëmirë Krasniqi '13 Curates the Kosovo Pavilion at the 2024 Venice Biennale, Which Has Been Awarded a Special Mention for National Participation", *Bard College Berlin*, 25 korrik 2024: https://berlin.bard.edu/news/eremire-krasniqi-13-curates-the-kosovo-pavilion-at-the-2024-venice-biennale-which-has-been-awarded-a-special-mention-for-national-participation [referuar më 7 korrik 2025]; "Kosovo Pavilion Highlights", *2024.pavilionofkosovo.com*, https://2024.pavilionofkosovo.com/highlights?lng=al [referuar më 7 korrik 2025].

me kufje dëgjimi, dorëshkrime e letra me shkrim dore. Materialet dhe dokumentacionet e paraqitura ndriçoheshin posaçërisht në mënyrë që të theksohej materiali dhe rëndësia e objekteve. Ndriçimi vinte nga lart dhe së brendshmi. Kjo ngjallte interes estetik.[26] (Fig. 1-2) Në një faqe muri me sfond të bardhë, ishte ngjitur një afishe muri me përmasa tejet të mëdha. Në të figuronin fragmente të shkëputura nga historitë orale të regjistruara, në përputhje me citatin kryesor të afishes ku shkruhej: "Diçka që do të mbetet për të tjerët, për pasardhësit." Jo shumë në distancë nga tryeza qendrore, të tërhiqnin vëmendjen tre ekrane televizori, vendosur në radhë e mbi tri kolona të bardha, në një lartësi prej 1.5 m, në të cilat shfaqeshin filma dokumentarë, si dhe filmime të ndryshme nga kanalet televizive. (Fig. 3) Një instalacion i posaçëm kombinonte një numër të madh kartash telefoni brenda një kubi prej materiali peçikllas të tejdukshëm, i vendosur edhe ky mbi një kolonë, dhe pranë tij një kostum të varur gruaje. (Fig. 4) Një faqe tjetër muri, në një zonë të veçantë, u përdor si ekran i gjerë për të shfaqur filma dokumentarë dhe fotografitë e koleksionit të fotografit Spiro Staveri. (Fig. 5) Ky *puzzle* instalacionesh plotësohet po t'i shtojmë edhe hapësirën e zhvillimit të bisedave të hapura që u organizuan me katër

[26] Ndriçimi i objekteve luan rol estetik dhe interpretues. Në të gjenden tipare thelbësore në vlerësimin e objekteve, pasi rrit qartësinë pamore si dhe rrëfimin e përgjithshëm interpretues të një hapësire apo objekti. Tërheq vëmendjen rreth karakteristikave kryesore të objektit dhe ngjall emocione duke mbështetur mesazhin tematik të ekpozitës. Në këtë drejtim, ndriçimi nuk është vetëm mjet për të vënë në dukje objektin, por edhe mjet i shprehjes artistike, pasi formëson perceptimin e ekspozitave dhe mbështet rrëfimin kuratorial. Shiko: Christopher Cuttle, *Light for Art's Sake: Lighting for Artworks and Museum Displays*, Oxford: Butterworth-Heinemann, 2007, f. 217.

tematika rreth rëndësisë së arkivit dhe aktualitetit politiko-shoqëror të emigracionit. (Fig. 6)

Ekspozita, si arkiv i hapur, e tejkalon rolin e të qenit objekt konsumi i informacionit nga publiku, duke e inkurajuar atë të bëhet aktiv nëpërmjet estetikës dhe instalacioneve të përdorura, të cilat mundësojnë ndërveprimin midis organizuesve dhe vizitorëve, që krijon intimitet dhe i fton këta të fundit të reflektojnë mbi historitë e grumbulluara. Kjo ndodh nëpërmjet praktikës së guidave dhe informimit të publikut rreth materialeve të ekspozuara si dhe vlerave të tyre historike dhe sociale. Gjithashtu, një praktikë e veçantë kuratoriale vihet re në hapësirën qendrore të ekspozitës, ku të jepet mundësia të kalosh nga arkivi oral në atë pamor. Këtu lidhja midis arkivave bëhet më kuptimplotë. Karriget e vendosura në qendër të hapësirës përreth tryezës kryesore të japin mundësinë të ulesh e të lexosh vëllimet e gazetave apo të dëgjosh intervistat me histori orale, duke e transformuar ekspozitën, nëpërmjet estetikës së dhënë, në një sallë leximi. Pranë historive orale, të cilat dëgjohen me kufje, janë vendosur materiale shoqëruese pamore të personit që ka dhënë intervistën. Si rrjedhojë, ekspozita arrin të krijojë kushtet që të përjetohet edhe eksperienca e kërkimit nëpër arkiv. Intimiteti i krijuar amplifikohet nëpërmjet regjistrimeve zanore, në të cilat zërat e emigrantëve, mënyrat e rrëfimit, tonet e zërit në pasazhet ku emigrantët tregojnë situata të dhimbshme apo të gëzuara, e transformuan galerinë në një hapësirë ku shpalosej përvoja e vetë emigrantëve/eve, duke e bërë edhe më tërheqëse ekspozitën për publikun.

Hapësira inkurajon vizitorët të shprehen e të shkëmbejnë përvojat e tyre, qoftë këta vendës apo emigrantë, nën një

shumëllojshmëri përvojash dhe ndjenjash: gëzime dhe hidhërime, krenari dhe modesti, zhgënjim dhe shpresë, vuajtje e dhimbje. Në këtë drejtim ekspozita perceptohet si fenomen i thellë emocional, politik e social, në raport me kujtimet personale dhe kolektive, të largimit nga vendi i lindjes, të periudhës së stabilizimit dhe sfidave të mbërritjes në vendin e destinacionit, të solidaritetit, të cilat përjetohen sërish. Publikut i jepet mundësia të njihet përmes kujtimeve të shkërmoqura: letra të zverdhura nga koha e të shkruajtura me dorë, një mur me fotografi dhe një tryezë me materiale që mbart fotografi të zbehura e pasaporta, na bëjnë të shohim të kaluarën nëpërmjet këtyre objekteve që janë simbolikisht të fuqishme, pasi ftojnë shikuesit dhe publikun të reflektojnë mbi përvojën e emigrantëve. Ekspozita nuk zhvillohet si një arkiv statik, por me histori të gjalla të zhvendosjes dhe përkatësisë (*belonging*) në hapësirë dhe kohë.

Nga ky këndvështrim, ekspozita i kundërvihet narrativave që e shqyrtojnë dhe inkuadrojnë emigracionin vetëm si problem shoqëror dhe politik. Përkundrazi, ajo ofron një lente, në të cilën materialet e paraqitura, me peshë të rëndë emocionale, bëhen jo vetëm përmbajtje kujtimesh, por nxjerrin në dukje vazhdimësinë e emigracionit si një element i qëndrueshëm i atribuuar tek njerëzit. Një mesazh të tillë na tregon pamja e një kostumi gruaje të varur në këmbalec, me të cilin emigrantja kaloi kufirin dhe që na bën të përfytyrojmë bagazhet e emigrantëve. Këtu objekti i arkivit mund të rikontekstualizohet simbolikisht, duke u transformuar në instalacion arti. Të njëjtin konkluzion nxjerrim duke vëzhguar borsën me telekarta të vendosura në një tezgë brenda një kubiku prej peçikllasi, nga përmbajtja e të cilave mund të hyjmë thellë në ndjenjën e mungesës dhe të largesës, pasi janë

këto karta si mjet që mundësonin komunikimin me atdheun. Kartat dhe letrat personale krijojnë përshtypjen e distancës me vendin e lindjes apo të identitetit të fragmentuar. Duke i vëzhguar, na shkon mendja te radhët e mbajtura në kabinat e telefonit, te shkëputja nga të afërmit, dëshira dhe domosdoshmëria e ruajtjes së lidhjeve shoqërore, miqësore e farefisnore. Këto karta bëhen argumente të ndjenjës së mungesës dhe humbjes, në kundërshtim me narrativat rreth asimilimit. Kështu që objektet transformohen estetikisht duke na zhytur në përsiatje më të thella.

Në të njëjtën kohë, objektet vendosen edhe në një këndvështrim historik, për t'u fokusuar në përpjekjet për integrim social. Këtë aspekt e vëmë re në materialet e mbledhura në lidhje me procesin e legalizimit. Këtu gjejmë karta jeshile, vërtetime 6-mujore, pasaporta, karta të bardha të lëshuara nga autoritetet greke. Në pjesën më të madhe, dokumentet dëshmojnë për proceset diskriminuese të së shkuarës, por që tingëllon tepër aktuale pasi fenomene të ngjashme ende vazhdojnë të ekzistojnë. Duke i vëzhguar, mund të imagjinojmë se si ato i referohen përvojave të trupit (radhët pa mbarim nëpër zyrat përkatëse për marrjen e një vërtetimi apo të kartës jeshile). Çdo procedurë kryhej nëpërmjet paraqitjes fizike nëpër zyra, e cila sjell si pasojë lodhjen psikologjike, diçka që e vëmë re nëpër historitë orale. Përfytyrimi i vizitorëve kalon nëpër periudha të ndryshme, nëpër letrat dhe dokumentet, në të cilat ndihen dhe vihen re mesazhe me shpresa të humbura dhe që ngjallin dhimbje, reagime emocionale jo vetëm për emigrantët por edhe për publikun në përgjithësi.

Në kundërshtim me narrativat që i paraqesin emigrantët

shqiptarë të pavullnetshëm politikisht, ekspozita na fton në një udhëtim historik dhe konceptual, duke kaluar nëpër labirinte rezistencash kolektive dhe individuale. Ndër objektet e paraqitura, në arkivin kolektiv të Forumit të Emigrantëve Shqiptarë mishërohen rezistenca ndaj dhunës sociale dhe zyrtare, ndaj asimilimit, si dhe ndjenjat e solidaritetit, duke përforcuar imazhin e identitetit dhe të sensibilizimit politik të emigrantëve. Në lidhje me dhunën raciale zyrtare apo shoqërore ndaj emigrantëve shqiptarë, ekspozita na ofron prizmin e luftës ndaj saj dhe ndaj paragjykimeve kulturore, duke theksuar dinamikat e paparashikueshme që ushtrohen në kohë dhe hapësirë. Itinerari i ekspozitës fokusohet në koncepte kyçe, si aftësia për vetëveprim (*agency*), fuqizimi dhe vetë-motivimi i emigrantëve shqiptarë. Del në dukje se, pavarësisht klimës shoqërore të ngurtësuar karshi dhunës së ushtruar, kjo duhet të trajtohet si një fenomen që i ka rrënjët thellë në shoqëri, rrënjë të cilat, në lidhje me aktualitetin, prekin komunitete të tjera sociale dhe etnike, gjithashtu të skajuara. Arkivi i Forumit në ekspozitë shoqërohej me shtjellimin e një prej tematikave kryesore, që lidhej me raprezaljet dhe pogromet ndaj emigrantëve shqiptarë shtatorin e vtit 2004, pas rezultatit të ndeshjes së futbollit Shqipëri–Greqi. Në këtë mënyrë, lidhja midis arkivit të ekspozuar dhe angazhimit dhe pjesëmarrjes së publikut në bisedë të hapur, lë vend jo vetëm për t'u njohur me këtë ngjarje historike, por edhe që ajo të shqyrtohet në lidhje me aktualitetin dhe sensibilizimin shoqëror.

Aspektin e sensibilizimit në ekspozitë e ndeshim edhe te forca e *ndjeshmërisë*, e cila i referohet aftësisë për ndërgjegjësim, për të kuptuar ndjenjat e dikujt (tjetër). Publiku e përjeton situatën dhe kjo shkakton sensibilizim dhe solidaritet. Ky aspekt

është veçanërisht i dukshëm në filmin *Otranto*. Filmi bazohet në tragjedinë e vitit 1997, kur anija "Katër i Radës" u mbyt pas silurimit nga marina italiane, duke shkaktuar vdekjen e 81 personave në bord. Në të dominon gjuha pamore, ndjeshmëria, dhimbja dhe tragjikja, nëpërmjet informacionit që jepet, shpesh në mënyrë të padukshme, pa qenë (shikuesi) domosdoshmërisht në dijeni të marrjes së këtij informacioni.[27] Kjo tematikë, si dhe të tjerat shoqërohen me biseda të hapura me publikun, në koherencë me çështjen e politikave mbi kontrollin dhe dhunën në kufij, si një problem aktual që përjetojnë emigrantët. Në këtë aspekt, ekspozita inkurajon për eksplorim të forcave që formësojnë emigracionin, si proces historik dhe realitet bashkëkohor, si një faktor kujtese i plagëve të trashëguara dhe shërimit të tyre.

Imazhin e emigrantit të suksesshëm, por pa histori, që dominon në mediat greke dhe jo vetëm, ekspozita me praktikat e adoptuara kërkon ta minojë. Forca e saj qëndron në mohimin e përgjithësimit të përvojave. Të gjithë këta faktorë na tregojnë se historia përbëhet nga momente intime, shpesh të lëna në harresë apo të konsideruara si të papërfillshme. Një aspekt të tillë na paraqet repertori me fotografi i Spiro Staverit. Në të fotografitë perceptohen si mjet vëzhgimi dhe reflektimi: rreth solidaritetit, dukshmërisë, bashkëjetesës. Ato janë dëshmi historike në një periudhë tranzicioni. Emigrantët fotografohen gjatë kalimit të kufirit, në rrugë, tarraca, sheshe e kafene. Rruga nënkupton përkohshmërinë, por edhe vetë ekzistencën brenda hapësirës.

[27] "A Quick Guide to Visual Style", *CinePunked*, 23 shtator 2022, https://cinepunked.com/2022/09/23/a-quick-guide-to-visual-style/ [referuar më 11 prill 2025].

Subjekti, nga i padukshëm, bëhet i dukshëm, duke zënë hapësirë brenda strukturës shoqërore. (Fig. 7-8)

Të paraqitura në ekspozitë nëpërmjet videoprojektorit në një faqe muri, shikimi përqendrohet në trupat e emigrantëve. Shprehjet e fytyrës janë shpresëdhënëse, tejet optimiste dhe në të njëjtën kohë të japin idenë e pritjeve të pafundme. Në fotografi, trupi i njeriut nuk është kurrë neutral. Në lidhje me emigrantët mban peshën e udhëtimit, të domosdoshmërisë së ikjes apo braktisjes, të historisë dhe padukshmërisë. Njerëzit qëndrojnë, ulen ose shtrihen në mënyrë jo të pozuar, por që sinjalizon përjetime të thella. Pra, qëndrimi funksionon si një gjuhë. Ai paraqet rrëfimin e vet. Është zëri i emigrantëve përmes një regjistrimi të heshtur të situatës. Trupa paksa të përkulur nga udhëtimi dhe lodhja, duart në xhepa, këmbë e krahë të kryqëzuar, janë një interpretim i pritjes, i pasigurisë, i qëndrimit pas ecjes për ditë të tëra teksa kalojnë kufirin. Trastat dhe qeset që mbartin janë simbole të jetës në tranzit. Toka – qoftë trotuar apo çimento – transformohet në një shtrat, në një vend për të pritur. Këtu hapësira private mungon ndërsa hapësira publike bëhet një trup, një përvojë, një identitet. Mungesa e strehimit interpretohet si mungesë e qëndrueshmërisë dhe e stabilitetit, por edhe si dëshmi e natyrës fluide të identitetit.

Emigrantët nuk paraqiten si figura të vetmuara. Përkundrazi, ata qëndrojnë pranë njëri-tjetrit, shpesh duke u prekur, duke folur, duke u përqafuar. Është një trup si një komunitet i vogël që ka krijuar lidhje gjatë udhëtimit. Ky kolektivitet, së bashku, bëhet një mburojë dhe burim solidariteti. Vështrimi bie ndesh me narrativën dominuese të të huajit (të shqiptarit të vetmuar, të shkëputur, kërcënues, dhe “armik i vetvetes”). Vështrimi i tyre

kërkon njohje, pretendon dukshmërinë, sjell një prani dinamike, të drejtpërdrejtë dhe të barabartë me shikuesin e fotografisë. Nuk shmang, nuk fshihet; përkundrazi, përpiqet të shpalosë praninë. Vështrimi dhe buzëqeshja kanë kuptimin e rezistencës dhe pranisë në hapësirë. Buzëqeshja e tyre, ndonjëherë e sikletshme, ndonjëherë e përmbajtur, sjell dinjitet dhe shpresë. Nuk e fton shikuesin të ndiejë keqardhje; përkundrazi, jep forcë. Është një buzëqeshje mirësie, sigurisht jo e shkujdesur, por plot dinjitet njerëzor. Edhe në pasigurinë që të krijon mjedisi social i panjohur, në disa fotografi, kjo buzëqeshje e përmbajtur bëhet një akt i heshtur rezistence. Një notë njerëzore në një kontekst që përndryshe mund të shkaktonte lajthitje emocionale. Kjo buzëqeshje deklaron se, edhe këtu, ka vend për marrëdhënie, për besim, për shpresë. Fotografi e kap këtë moment përmes objektivit të tij dhe e lë atë si një kujtim historik. Tashmë ato janë dëshmi dhe jo vetëm prova të emigracionit. Ato janë tekste antropologjike, ku trupi, shikimi dhe qëndrimi funksionojnë si fusha intensive semiotike. Emigranti, siç e shohim këtu, nuk është një figurë anonime, por merr një dimension midis humbjes, frikës dhe shpresës, humbjes (sërish) dhe një fillimi të ri.

- **Epilog**

Përmes praktikave kuratoriale dhe materialeve të paraqitura, shpaloset dimensioni i lidhjes midis politikës parafytyruese, praktikave kuratoriale dhe atyre artistike, ç'ka mundëson krijimin e terrenit të përshtatshëm për të konceptuar dhe konkluduar se si praktikat e artit organizojnë forma parafytyruese të bashkëjetesës dhe solidaritetit. Kjo arrihet nëpërmjet angazhimit dhe pjesëmarrjes së publikut. Në ekspozitën e arkivit,

ndërsa emigrantët bëhen objekt i ekspozitës, larmia e vizitorëve zgjerohet dhe shumëfishohet, duke u përkthyer jo thjesht në vëzhgues, por edhe në pjesëmarrës aktivë, të cilët mund t'i kategorizojmë si aktivistë, si një faktor që e zbeh vijën e demarkacionit midis "vendësve dhe të huajve". Konkretisht, ekspozita ofron një botëkuptim rreth konceptit se si aktivistët ndërtojnë kujtesën sociale dhe veprimtarinë e tyre, dhe në ç'mënyrë përgatitin kushtet që këto lëvizje të bëhen objekt kujtese në të ardhmen. Edhe pse shumë materiale në ekspozitë u paraqitën për të kundërshtuar versionet e opinionit publik, qëllimi i kuratoreve-aktiviste nuk ishte vetëm që të hidhnin poshtë një kujtesë para-ekzistuese, por edhe që të krijonin një të re.[28] Në këtë aspekt e kaluara jep mundësinë për (ri)aktivizimin e brezit të ardhshëm. Si një praktikë kujtese aktive, arkivimi kthehet në aktivizëm politik jo vetëm nëpërmjet tematikave që shtjellohen në ekspozitë dhe praktikave kuratoriale, por edhe përmes procesit edukativ dhe brumosjes me narrativa të solidaritetit. Në këtë mënyrë karakteri parafytyrues bëhet i ndjeshëm dhe publiku rikujton objektivat për një shoqëri të ardhme me vlera e parime të reja. Si "hapësirë parafytyruese", ekspozita synon të krijojë terrenin për një të tashme që hap rrugën për të ardhmen e dëshiruar. Përmes ruajtjes dhe respektit të të dhënave historike, zërave dhe materialeve, ajo ndërton një përvojë hapësinore të prekshme (*sensible*) që evokon emocione dhe kujtime, të cilat rikumbojnë përtej fakteve.

---

[28] Ann Rigney, "Prefigurative Remembrance: Archiving as Activist Mnemonic Practice", *Memory Studies* vëll. 17, nr. 5, 2024, f. 1195–1212 (f. 119): https://doi.org/10.1177/17506980241262182 [referuar më 25 korrik 2025].

Përvoja e emigracionit nuk është e lehtë të regjistrohet si një akt kuratorial në një ekspozitë, duke rikujtuar fjalët e kuratores Pati Vardhami. Në ekspozitë dominonte karakteri shkencor dhe politik, ndërsa në aspektin artistik përbënte një sfidë e që kërkohej të përpunohej më tepër. Duke e parë në këtë prizëm, arti mund të shërbejë si një formë e ndërmjetme që ngjall emocione, përjetime dhe ndikon në thellimin e publikut mbi çështjet e emigracionit. Roli dhe rëndësia e artit në ndërtimin e ekspozitave muzeale apo kulturore që lidhen me historinë e emigracionit është thelbësor pasi shmang "tjetërsimin" e përgjithësuar të emigrantëve duke krijuar një distancë kritike midis shikuesve dhe objekteve.[29] Sidoqoftë, është i konsiderueshëm fakti se për herë të parë "flasin" emigrantët dhe zërat e tyre dëgjohen. Nëpërmjet tyre, por edhe organizimit kuratorial të ekspozitës, arrihet dekonstruktimi i narrativave rreth asimilimit të emigrantëve shqiptarë, si edhe i "historive të suksesit", të cilat sfidoheshin nëpërmjet estetikës së dhimbjes, tragjikes dhe të rezistencës.

Referenca

"A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration". *Stavros Niarchos Foundation Public Humanities Initiative*, https://snfphi.columbia.edu/events/a-bag-full-of-telephone-cards/ [referuar më 4 korrik 2025].

"A Quick Guide to Visual Style". *Cine Punked*, 23 shtator 2022,

[29] Barbara Wolbert, "Studio of Realism: On the Need for Art in Exhibitions on Migration History", *Forum Qualitative Sozialforschung / Forum: Qualitative Social Research* vëll. 11, nr. 2, 2010, Art. 34, f. 21: http://nbn-resolving.de/urn:nbn:de:0114-fqs1002345 [referuar më 7 mars 2025].

https://cinepunked.com/2022/09/23/a-quick-guide-to-visual-style/ [referuar më 11 prill 2025].

Appadurai, Arjun. "Archive and Aspiration". *The Archive Public*, 2012, https://archivepublic.wordpress.com/texts/arjun-appadurai/ [referuar më 1 mars 2025].

Black, Graham. *The Engaging Museum: Developing Museums for Visitor Involvement*. Londër: Routledge, 2005.

Bourriaud, Nicolas. *Relational Aesthetics*. Përkth. nga Simon Pleasance dhe Fronza Woods. Dijon: Les Presses du Réel, 2002.

Cuttle, Christopher. *Light for Art's Sake: Lighting for Artworks and Museum Displays*. Oxford: Butterworth-Heinemann, 2007.

Daniel, Dominique. "Documenting the Immigrant and Ethnic Experience in American Archives". *The American Archivist*, vëll. 73, nr. 1, 2010, f. 82–104, http://www.jstor.org/stable/27802716 [referuar më 1 tetor 2025].

"Decolonising the Archive". *Decolonising the Archive*, https://www.decolonisingthearchive.com/about [referuar më 4 korrik 2025].

"Erëmirë Krasniqi '13 Curates the Kosovo Pavilion at the 2024 Venice Biennale, Which Has Been Awarded a Special Mention for National Participation". *Bard College Berlin*, 25 korrik 2024, https://berlin.bard.edu/news/eremire-krasniqi-13-curates-the-kosovo-pavilion-at-the-2024-venice-biennale-which-has-been-awarded-a-special-mention-for-national-

participation [referuar më 7 korrik 2025].

Foucault, Michel. *The Archaeology of Knowledge*. Përkth. nga A. M. Sheridan Smith. Londër dhe Nju Jork: Routledge, 2005.

——. "Of Other Spaces: Utopias and Heterotopias". Përkth. nga Jay Miskowiec. *Architecture / Mouvement / Continuité*, tetor 1984, https://web.mit.edu/allanmc/www/foucault1.pdf [referuar më 2 tetor 2025]. Fillimisht paraqitur si "Des Espaces Autres", mars 1967.

Ibreck, Rachel, Peter Rees dhe Martina Tazzioli. "Counter-Archiving Migration: Tracing the Records of Protests against UNHCR". *International Political Sociology*, vëll. 18, nr. 4, 2024, https://doi.org/10.1093/ips/olae035 [referuar më 16 prill 2025].

Juliani, Richard N. "The Use of Archives in the Study of Immigration and Ethnicity". *The American Archivist*, vëll. 39, nr. 4, 1976, f. 469–477, http://www.jstor.org/stable/40291919 [referuar më 09 korrik 2025].

Kaplan, Elisabeth. "We Are What We Collect, We Collect What We Are: Archives and the Construction of Identity". *The American Archivist*, vëll. 63, nr. 1, 2000, f. 126–151, https://doi.org/10.17723/aarc.63.1.h554377531233l05 [referuar më 12 korrik 2025].

"Koncepti kuratorial i projektit 'Heshtjet kumbuese të metalit dhe lëkurës'". *Gazeta Express*, 18 mars 2024, https://www.gazetaexpress.com/koncepti-kuratorial-i-projektit-heshtjet-kumbuese-te-metalit-dhe-lekures/

[referuar më 07 korrik 2025].

"Kosovo Pavilion Highlights". *2024 Pavilion of Kosovo*, https://2024.pavilionofkosovo.com/highlights?lng=al [referuar më 7 korrik 2025].

Krasniqi, Erëmirë dhe Renea Begolli. "Conversation Between the Secondary Archive Kosovo Curators". *Dealing with the Past*, 29 mars 2023, https://dwp-balkan.org/secondary-archive/ [referuar më 8 korrik 2025].

Lobo, Roxanne. "Archive as Prefigurative Space: Our Lives and Black Feminism in Canada". *Archivaria*, nr. 87, 2019, f. 68–86, https://archivaria.ca/index.php/archivaria/article/view/13667 [referuar më 10 korrik 2025].

Mangalam, J. J., dhe Harry K. Schwarzweller. "General Theory in the Study of Migration: Current Needs and Difficulties". *The International Migration Review*, vëll. 3, nr. 1, 1968, f. 3–18, https://doi.org/10.2307/3002178 [referuar më 16 korrik 2025].

Musaraj, Ilirida. "Historicization, Memory, and Antagonistic Narratives: Creating the Archive of Albanian Migration". Kumtesë mbajtur në simpoziumin *RE:membering the Past* (Aristotle University, Athinë/Greqi) më 17 maj 2024, https://www.new.enl.auth.gr/re-membering-the-past/historicization-memory-and-antagonistic-narratives-creating-the-archive-of-albanian-migration/ [referuar më 1 prill 2025].

"Projects – DOMiD | Documentation Center and Museum of Migration in Germany", *DOMiD*, https://domid.org/en/about-us/projects/ [referuar më 5

korrik 2025].

Reiss, Julie H. *From Margin to Center: The Spaces of Installation Art*. Cambridge, MA: MIT Press, 1999.

Rigney, Ann. "Prefigurative Remembrance: Archiving as Activist Mnemonic Practice". *Memory Studies*, vëll. 17, nr. 5, 2024, f. 1195–1212: https://doi.org/10.1177/17506980241262182 [referuar më 25 korrik 2025].

Robinson-Sweet, Anna dhe Michelle Caswell. "Paying It Forward: The Prefigurative Politics of Record Creation". *KULA: Knowledge Creation, Dissemination, and Preservation Studies*, vëll. 8, nr. 1, 2025, https://doi.org/10.18357/kula.292 [referuar më 18 korrik 2025].

Sellie, Alycia, Jesse Goldstein, Molly Fair dhe Jennifer Hoyer. "Interference Archive: A Free Space for Social Movement Culture". *Archival Science*, nr. 15, 2015, f. 453–472: https://doi.org/10.1007/s10502-015-9245-5 [referuar më 20 korrik 2025].

Siegenthaler, Fiona dhe Cathrine Bublatzky. "(Un)Sighted Archives of Migration—Spaces of Encounter and Resistance: An Introduction". *Visual Anthropology*, vëll. 34, nr. 4, 2021, f. 283–295, https://doi.org/10.1080/08949468.2021.1944766 [referuar më 16 prill 2025].

Simon, Nina. *The Participatory Museum*. Santa Cruz, CA: Museum 2.0, 2010.

Shehu, Ervin. "Komunitetet e migracionit: ndikimi i konceptimeve në protestat sociale". *Teza11*, 29 prill 2023,

https://teza11.org/komunitetet-e-migracionit-ndikimi-i-konceptimeve-ne-protestat-sociale/ [referuar më 5 korrik 2025].

Wolbert, Barbara. "Studio of Realism: On the Need for Art in Exhibitions on Migration History". *Forum Qualitative Sozialforschung / Forum: Qualitative Social Research*, vëll. 11, nr. 2, 2010, Art. 34, http://nbn-resolving.de/urn:nbn:de:0114-fqs1002345 [referuar më 7 mars 2025].

Fig. 1. Pamje nga ekspozita *A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration* (*Një borsë plot me telekarta: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar)*. Foto: ASKI (Arkivi i Historisë Sociale Bashkëkohore). Riprodhuar me lejen e ASKI-t.

Fig. 2. Dokumente personale dhe certifikata të emigrantëve shqiptarë, të ekspozuara në kuadër të projektit *A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration* (*Një borsë plot me telekarta: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar)*. Foto: ASKI (Arkivi i Historisë Sociale Bashkëkohore). Riprodhuar me lejen e ASKI-t.

Fig. 3. Instalacion me tre ekrane që shfaqin imazhe të kujtesës kolektive. *I nderuar* (2004), M. Sidiropoulou & I. Musarai, video me tre kanale. Pjesë e ekspozitës *A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration* (*Një borsë plot me telekarta: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar).* Foto: ASKI (Arkivi i Historisë Sociale Bashkëkohore). Riprodhuar me lejen e ASKI-t.

Fig. 4. Objekte personale të emigrantëve shqiptarë, përfshirë një xhaketë dhe telekarta, si pjesë e kujtesës materiale të emigracionit. Pjesë e ekspozitës *A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration* (*Një borsë plot me telekarta: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar).* Foto: ASKI (Arkivi i Historisë Sociale Bashkëkohore). Riprodhuar me lejen e ASKI-t.

Fig. 5. Projektime audiovizuale të emigrantëve dhe emigranteve shqiptare, 1990-1991. Pjesë e ekspozitës *A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration* (*Një borsë plot me telekarta: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar).* Foto: ASKI (Arkivi i Historisë Sociale Bashkëkohore). Riprodhuar me lejen e ASKI-t.

Fig. 6. Bisedë e hapur me publikun, pjesë e programit shoqërues të ekspozitës *A Bag Full of Telephone Cards: Making the Archive of Albanian Migration* (*Një borsë plot me telekarta: Krijimi i Arkivit të Emigracionit Shqiptar)*. Foto: ASKI (Arkivi i Historisë Sociale Bashkëkohore). Riprodhuar me lejen e ASKI-t.

Fig. 7. Fotoreportazh "Eksodi i madh drejt Greqisë", 1991. ASKI / Koleksioni i Spiro Staverit.

Fig. 8. Emigrantë shqiptarë në Greqi, 1991. ASKI / Koleksioni i Spiro Staverit.